

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DEGA VENDORE E NOTERISE TIRANE

Nr. 1103 Rep.

Nr. 427 Kol.



KONTRATË SHITJE KUOTASH KAPITALI TË SHOQËRISË
“ZYRËE PËRMBARIMIT PRIVAT BAILIFF SERVICE E.HOXHA” SH.P.K.

Sot më datë 14 Shtator 2020 (Dymijë e njëzet), përpara meje Noterit Muli Y.MALLKUÇI, anëtar i Degës Vendore të Noterisë Tiranë, me seli në adresën “Vaso Pasho”, pall.13/1, Tirane, u paraqitën personalisht palët:

SHITËSI:

Ortaku z. Elvin Hoxha, i biri Gëzimit, i datëlindjes 17.11.1975, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me nr. ID personal H51117031Q, ortak i vetëm i shoqërisë “Zyrës Përmbarimit Privat BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k. zotërues 1 (kuote) me vlerë të përgjithshme 10,000 lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

BLERËSI:

Z. Ervin Kryeziu, i biri Agron, i datëlindjes 12.08.1982, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, me nr. ID personal I20812086O, me profesion Përmbarues Gjyqësor Privat, i linçesuar nga Ministria e Drejtësisë me Liçensën Nr.154 Mars 2013.

Kushte paraprake:


1. Shitësi Elvin Hoxha sipas dokumentacionit të shoqërisë “Zyrës Përmbarimit Privat BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k. si dhe verifikimit të bërë në QKB është ortak i vetëm zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Të gjitha të dhënat e detyrueshme të shoqërisë “Zyrës Përmbarimit Privat BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k. janë përshkruar në dokumentin e dates 14.09.2020 “Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e Subjektit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar - Gjëndja e Regjistrimit”, bashkëlidhur kësaj kontrate.
3. Shitësi Elvin Hoxha pronar 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë është i interesuar të shesi 100% të kapitalit të shoqërisë.

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake palët bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë shitblerjeje kuotash pjesëmarrje në shoqëri me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në përputhje me dhe në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil Shqiptar, nenit 73, paragrafi 1, shkronja e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe dokumentacionit të krijimit të shoqërisë. Çdo çështje që nuk rregullohet nga kjo kontratë rregullohet në bazë të dispozitave të Kodit Civil dhe ligjit nr.9901,



datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Neni 2

Objekti i kontratës

Ortaku i vetëm i shoqërisë, me Vendimin Nr.4, datë 14.09.2020, bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Statutin e shoqërisë, ka vendosur lejimin e largimit nga shoqëria të ortakut të vetëm z. Elvin Hoxha dhe transferimin nëpërmjet shitjes të kuotave që ai zotëron në këtë shoqëri, në favor të z. Evin Kryeziu, i cili bëhet ortak i vetëm i kësaj shoqërie, njëkohësisht administrator i saj.

Neni 2

Çmimi i shitjes dhe detyrimet ligjore për regjistrim të ndryshimit të pronësisë Çmimi i shitjes së këtij kapitali të zotëruar nga ortakut i vetëm z. Elvin Hoxha dhe që transferohet nëpërmjet kësaj kontrate në favor të Z. Ervin Kryeziu është 10,000 (dhjetë mijë) lekë, me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pavarësisht nënshkrimit të kësaj kontrate BRERESI shprehet dakort se fitimi që ka realizuar shoqëria dhe tarifat përmbartimore të arkëtuara deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate të cilat janë marrë nga administratori dhe ortakut i vetëm Z.Elvin Hoxha, i nglen SHITËSIT z. Elvin Hoxha.

BLERËSI, z. Ervin Kryeziu, bëhet ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “Zyrë Përmbartimit Privat BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k., njëkohësisht me detyrën e Përmbartuesit Gjyqësor pranë kësaj zyre përmbartimore, ka detyrimin të regjistrojë menjëherë këtë kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 3

Garancitë



Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetimi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor. Shitësi deklaron se shoqëria “Zyrë e Përmbartimit Privat BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k. deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, i ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj ndaj organeve tatimore dhe paleve te treta.

Neni 4

Heqja dorë nga të drejtat dhe detyrimet

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se me nënshkrimin e kësaj kontrate heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë deri në këtë moment mbi kuotat e transferuara nëpërmjet shitjes.

Blerësi deklaron nën përgjegjësinë e tij se merr të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.





Neni 5

Zhveshja nga detyrimet

Pas realizimit të këtij transferimi, me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje, shitësi z.Elvin Hoxha, zhvishet nga çdo e drejtë dhe detyrim në shoqërinë “Zyrë e Përmbartimit Privat BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k.

Neni 6

Marrja në dorëzim e dosjeve përmbartimore

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje kuotash, ortaku i rimerr në dorëzim dosjet përmbartimore të regjistruara për ekzekutim pranë shoqërisë, sipas listës bashkëlidhur, e cila është pjesë integrale dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Pas një kontrolli paraprak dhe verifikimit të bërë dosjeve, ortaku i rideklaron se nuk është konstatuar asnjë parregullsi ose mungesë dokumentacioni në to.

Neni 7

Çfarë nuk është e parashikuar në këtë kontratë mbi transferimin e kuotave nëpërmjet shitjes, rregullohet në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.


Bashkëlidhur kësaj kontrate, pjesë dhe e pandashme e saj gjëndet bilanci i shoqërisë “Zyrë e Përmbartimit Privat BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k. përperiudhën 01.01.2020 – 31.08.2020.

Kjo kontratë u hartua në 4 kopje origjinale me vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua dhe u kuptua, palët deklaruan se janë dakord me sa mësipër, duke nënshkruar me vullnetin e tyre të lire dhe të plotë pa vërejtje.

Unë noteri e vërtetoj atë konform nenit 705e vijues të Kodit Civil Shqiptar dhe ligjit nr.110/2018 datë 20.12.2018 “Për noterinë”. Akti u redaktua në 4 (katër) njësi të baravlershme origjinale në gjuhën shqipe.


SHITËSI

Ortaku i vetëm i shoqërisë
“Zyrë e Përmbartimit Privat
BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k.
Elvin Hoxha



BLERËSI


Ervin Kryeziu



NOTER

Muli Y.MALLKUÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81722046V	
2. Data e Regjistrimit	22/05/2018	
3. Emri i Subjektit	Zyrë e Përmbarrimit Privat Bailiff Service E.Hoxha	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	16/05/2018	
6. Kohëzgjatja	Nga: 16/05/2018	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Vaso Pasha, Pallati 13/1	
8. Kapitali	10.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Kryerjen e veprimtarise permbarimore gjyqesore private per ekzekutimin e titujve ekzekutiv sipas legjislacionit ne fuqi.	
10. Administratori/ët	Elvin Hoxha	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 16/05/2018	Deri: 16/05/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	ElvinHoxha	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 10.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Zyrë e Përmbarrimit Privat Bailiff Service E.Hoxha	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	E-Mail: elvinth@hotmail.com Telefon: 0682029920
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 14/09/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga Web